



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PUKË  
KËSHILLI BASHKIAK

Komisioni i Përhershëm për Ekonomi dhe Financë

RAPORT VENDIMMARRJE

Nr. 2 datë 17.04.2025

**Drejtuar:** Këshillit të Bashkisë

**Lenda:** Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit nr. 3 datë 09/04/2025, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin për "Për miratimin e taveve përgatitore të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028 për Bashkinë Pukë"

**Analiza ligjore:** Mbështetur në ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" te ndryshuar, nenin 34 të ligjit nr.68/2017 "Për financat e veteqeverisjes vendore" i ndryshuar ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar; ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, udhezimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23 date 30.07.2018" Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të Njësisve të Vetëqeverisjes Vendore te ndryshuar, udhezimin plotesues të Ministrise se Financave dhe Ekonomisë nr. 8 date 28.02.2025 Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesem vendor 2026-2028 dhe shtojcat përgatitore" Pas miratimit te kalendarit ne zbatim te shkreses Ministrise Financave nr 4074/1 date 04.03.2025, akordimin e fondeve buxhetore si dhe parashikimin e te ardhurave per vitin 2026 jane hartuar tavanet buxhetore.

**Situata aktuale e funksionit:**

Ne baze te udhezimit plotesues nr. 8 dati 28.02.2025 " Per përgatitjen e programit buxhetor afatmesem vendor 2026-2028" si dhe projekt raportit me objekt" Per miratimin e raportit te vlersimeve dhe parashikimeve afatmesme te Bashkise Puke per vitet 2026- 2028" burimet e financimit per PBA 2026-2028 jane si me poshte.

Burimet e financimit	PBA 2026	PBA 2027	PBA 2028
Transferta e pakushtëzuar e Përgjithshme	193,067,110	198,647,381	204,089,589
Transferta e Pakushtëzuar Sektoriale	141,929,299	141,929,299	141,929,299
Total buxheti qendror	334,996,409	340,576,680	346,018,888

Të Ardhura nga Burimet e Veta	59,545,000	59,145,000	59,145,000
Totali i të Ardhurave	394,541,409	399,721,680	405,163,888

**Situata financiare :** Bashkia Puke po ndjek te gjithë fazat e hartirmin te buxhetit sipas afateve te percaktuara në udhezimin perkates. Pas miratimit ne Keshill te tavanëve, do te behen degjiesat publike ne te gjitha njesite vendore qe mbulon bashkia sipas nje grafiku te percaktuar.

Buxheti per vitin 2026 do te jete në shumen 394,541,409 lekë dhe për vitet ne vijim do të jetë 399,721,680 dhe 405,163,888 Lekë.

**Drejtoria / Sektori përgjegjës:**

Drejtoria e financës ka relatuar përpara komisionit për Tavanet buxhetore 2026 - 2028

**Monitorimi dhe raportimi :** Komisioni i Ekonomisë dhe Financave dhe të gjithë këshilltarët do të monitorojnë zbatimin e buxhetit dhe do të thërrasin sa herë të jetë nevojshme drejtorinë e Finances ose Drejtorinë përgjegjëse për zbatimin e projekteve të caktuara.

**Impakti social / grupet që preken:** Dokumenti i tavanëve përgatitore të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028 per Bashkinë Pukë impakton Buxhetin e viteve te ardhshme dhe rrjedhimisht jetën e të gjitha shtresave, kategorive dhe zhvillimin e të gjithë territorit të bashkisë Pukë

Komisioni i Përhershëm për “ Ekonomi dhe Financë” , i mbledhur me datën 17.04. 2025, shqyrtoi projekt vendimit nr.3 datë 9 /04/2025 relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin për “Për miratimin e tavanëve përgatitore të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028 per Bashkinë Pukë” paraqitur nga Kryetari i Bashkisë.

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese, Komisioni me shumicë votash,

**VENDOSI:**

1. T'i propozojë Këshillit Bashkiak:
  - a) kalimin e projektaktit në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim
  - b) miratimin e projektaktit

**Kryetar i Komisionit**

(emri, mbiemri, firma)

*BSOY BSOKA*

(emri, mbiemri, firma)

*Besmira Aliqj*

**Sekretar i Komisionit**

*Andor i komisionit*

Datë 17.04. 2025